Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komunikatë

10.07.2013

Në mbledhjen e 31-të të radhës të kryesuar nga kryetarja, znj. Valdete Daka, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtur disa nga aktivitetet kryesore. Fillimisht, kryetarja Daka, i ka noftuar anëtarët e KQZ-së lidhur me vizitën e saj të realizuar në Bruksel.

Kryeshefi Enis Halimi, e ka informuar KQZ-në me aktivitetet kryesore të lidhura me harmonizimin e Planit Operacional.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, ka rekomanduar që të bëj ç'regjistrimin e partisë politike: Iniciativa Sociale e Kosovës-ISK, e cila ishte regjistruar më 20.06.2013. KQZ, e ka miratuar këtë rekomandim.

Këshilli për Personel, e informoi KQZ-në për vendimin e KQ-së për shpalljen e konkursit për pozitat Zëvendësi i Kryeshefit të SKQZ-së dhe Zëdhënës të KQZ-së të datës 06.06.2013, me datën 19.06.2013. Florian Dushi, tha se, për arsye të mospëmbushjes së kriterit të aplikantëve të komunitetit jo shumicë, konkrusi për zëdhënës është shtyrë edhe për shtatë ditë të tjera: prej datës 10, deri më 17 korrik. Kurse për zëvendëskryeshef, në konkurs kanë aplikuar vetëm dy kandidat dhe, nuk është përmbushur kushti i procedurave të rekrutimit për Shërbyesit Civil, që është pranimi i së paku pesë aplikuesve. Në bazë të gjendjes, ky konkurs është rekomanduar që duhet të rishpallet. Anëtarët e KQZ-së, vendosën që sipas rekomandimit të Këshillit për Personel, të bëhet rishpallja e konkursit me afat të shkurtër kohorë për këtë pozitë. Florian Dushi, e informoi KQZ-në lidhur me përgatitjet që po bëhen për rekrutimin e stafit jo permanent për zgjedhjet Lokale 2013.

Ilir Gashi, kryesues i Këshillit për Buxhet dhe Prokurim, e njoftoi KQZ-në me projektin për Informim Publik. Alban Krasniqi, kryesues i KOZ-it, tha se, e informoi KQZ-në për rishqyrtimet dhe ndryshimet në Planin Operacional. Anëtarët e KQZ-së, aprovuan datën e 28 tetorit, si datë kur Fletvotimet duhet të jenë në depo. Në fund të kësaj pike, anëtarët e KQZ-së e miratuan përfundimisht Planin Operacional të zgjedhjeve, dhe u kërkua që plani të publikohet në Ueb faqe.

Alban Krasniqi, referoi edhe lidhur me kornizat-dizajnet e distinktivave për kategoritë e vëzhguesve të zgjedhjeve, si për vëzhguesit vendor ashtu edhe ata ndërkombëtar. Pas analizës detale, KQZ miratoi (3) format e dizajnit të Distinktivëve Identifikues për Vëzhguesit e Zgjedhjeve Lokale 2013, duke e autorizuar ZRPP-në për implementimin e këtij vendimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve